

FINCA Kosovë është Institucion Mikro Financiar, që operon në Euroazi, Lindje të Mesme, Afrikë dhe Amerikë Latine, shpall:

FTESE PËR OFERTË

Institucioni Mikrofinanciar FINCA Kosovë, fton të gjitha Kompanitë e interesuara që të ofertojnë për Tenderin në vijim:

“Ofrimi i paisjeve të GPS për monitorim të automjeteve të FINCA Kosovës” me numër të prokurimit FINCA-102/25

Të interesuarit mund ta marrin specifikacionin për aplikim prej datës 24 Shkurt 2025 në web faqe të FINCA Kosovës www.fincakosovo.org ose përmes emailit zyrtar në: ks.procurement@fincakosovo.org.

Vërejtje:

- Malli dhe / ose shërbimet duhet të jenë me kualitet të lartë dhe me çmime të volitshme, TVSH-ja duhet të jetë e përfshirë brenda çmimit.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë dy muaj (60 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Çmimet kuotohen për njësi në Euro (€).
- Eksperienca e ofertuesit për punë të ngjashme (të bashkangjiten së paku tre referenca nga Institucionet me reputacion në Kosovë të cilat vërtetojnë se Ofertuesi ka kryer punë të ngjashme ashtu si parashihet në Kontratë).
- Adresa e plotë dhe detajet për kontakt të Ofertuesit.
- Secila faqe duhet të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga Drejtori i Kompanisë.
- FINCA Kosovë mban të drejtën për të bërë ndryshimin në specifikacion, të anulojë këtë Tender, të ri-ftojë pjesëmarrësit individual për të riparuar ofertën e tyre, të diskualifikojë një ofertues pa dhënë njoftim apo arsye.
- Ofertat të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë dokument, mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
- Asnjë shpenzim që bëhet gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kuotimit të çmimit nuk do të kompensohet nga FINCA Kosovë.
- Kriteret për përzgjedhje në këtë Tender bazohen në vendimin e Komisionit për Tender dhe të Bordit Menaxhues.

Oferta në zarf të mbyllur për Departamentin e Administratës dhe e shënuar qartë me numër të Tenderit duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të FINCA Kosovës (Robert Doll Nr.112, Prishtinë), ose përmes postës elektronike në ks.procurement@fincakosovo.org.

Ofertat e dërguara përmes postës elektronike duhet të jenë të mbrojtura me fjalëkalim i cili duhet të lirohet ose të dërgohet 48 orë pas afatit për dorëzim.

Për informata shtesë ju lutemi kontaktoni përmes emailit në: ks.procurement@fincakosovo.org

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është e marte, 11.03.2025 në orën 16:00.

FINCA Kosovë, Robert Doll 112, 10000 Prishtinë

FINCA Kosovë Zyra Qendrore Rr. Robert Doll, Nr.112 10000 Prishtina + 383 (0) 38-609-721 + 383 (0) 38-609-722
Kosovo.FINCA.org

